



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2021:207152

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06447684

PPP.nr.38/21

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik**, si gjykatë përmbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar përmbarues, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, duke vendosur në çështjen përmbarimore të kreditorit B. B. dhe D. B. nga Ferizaji të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat V. M. rr.”...”, pa nr. Komuna Ferizaj, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, e duke vendosur lidhur me prapsimin e debitorit, më dt.13.11.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET**, në tërësi si i pabazuar Prapësimi i debitorit, Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë, i ushtruar më dt.29.03.2021, kundër Urdhërit Përmbarues me P.nr.120/2021 i dt. 12.03.2021.

**II. DETYROHET**, debitori që ta bëjë ekzekutimin e propozimit Urdhërit Përmbarimor P.nr.120/2021 i dt. 12.03.2021, lëshuar nga përmbaruesi privat B. H.A., me seli në Ferizaj, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas specifikacionit të llogaritur nga ana e përmbaruesit privat, kjo pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori B. B. dhe D. B. me përfaqësuesin e tyre prindi S. B. nga fsh ..., Komuna e Vitës, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat V. M. rr.”...”, pa nr. Komuna Ferizaj, tek përmbaruesi private B. A. me seli në Ferizaj, e kanë dorëzuar propozimin për përmbarim kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “...” me seli në Prishtinë.

Me këtë propozim, ka kërkuar që të lëshohet Urdhër dhe të lejohet përmbarimi sipas propozimit dhe të deyrohet debitori që në afat prej 7 ditësh, kreditorit të ja paguaj në emër të kamatëvonesës të shumës e të hollave në vlerë prej 35.00€, këtë shumë e ka kërkuar duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.258/2016 i datës 20.06.2018, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3469/2018 i datës 21.01.2021 i plotfuqishëm me datë 21.01.2021, Po ashtu këtë shumë e ka kërkuar me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data 20.06.2018 e deri me datë 24.02.2021. Me këtë propozim i ka kërkuar që të paguhet edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 175.50€, E tëra kjo përmes bllokimit të llogarive në cilëndo bankë qofshin ato të debitorit, si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në pagesën e borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat më dt.12.03.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit , Kompania e Sigurimeve “Sigkos” me seli në Prishtinë, ndërsa me nga një kopje të propozimit është njoftuar debitori i cili në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim.

Përmbaruesi privat një kopje të propozimit për përmbarim së bashku me urdhërin për lejimin e ekzekutimit, me datën 16.03.2021 i`a ka dorëzuar debitorit, i cili më datë 29.03.2021, ndaj urdhërit përmbarues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.120/2021 i dt. 12.03.2021.

Debitori me prapësim i ka propozuar gjykatës, që prapsimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet urdhëri i përmbaruesit privat nr. P.nr.120/2021 i dt. 12.03.2021, si të pa bazuar.

Ndaj këtij prapësimi kreditori për mes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigjen në prapsim ku ndër të tjera ka theksuar se urdhëri përmbarimorë i përmbaruesit privat është caktuar në bazë të titullit të rregullt përmbarimor siç është Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.258/2016 i datës 20.06.2018, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit

Ac.nr.3469/2018 i datës 21.01.2021 i plotfuqishëm me datë 21.01.2021 si dhe shkaqet e paraqitura me prapsim janë të pa qëndrueshme.

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, për arsye se debitorët prapësimin nuk e ka mbështetur në provat, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimin siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.12 të LPP-së.

Gjykata e analizoi prapësimin e debitorit si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe gjeti se prapsimi i debitorit është i pa bazuar dhe të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar, sepse pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura si më lart jo vetëm që nuk kishin mbështetje provuese, por të njëjtat ishin të pa justifikueshme në aspektin ligjor.

Faktet e paraqitura nga ana e debitorit siq janë: se debitori në bazë të provave të ofruar për llogaritjen e kamatës prej 8% ka paguar shumën prej 968.70€, jo siq pretendon kreditori në propozimin për përmbarim kinse është paguar shuma prej 936.82, dhe ka theksuar se llogaritja e kamatës vendoset nga gjykata duhet të jetë 8% e jo siq e ka llogaritur kreditori shumën 971.54 €, e cila shumë siq pretendohet nga kreditori se debitori ka paguar më pak se 34 € në emër të kamatës, dhe thekson se kreditori nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me pretendimet e tij se janë paguar më pak se 35€ në emër të kamatës, të gjitha këto e bëjnë jo të bazuar dhe jo serioz propozimin për përmbarim dhe mund të konstatohet se ky propozim për përmbarim është bërë vetëm për të shkaktuar shpenzime procedurale nga të cilat do të përfitojë avokati i kreditorit pa bazë ligjore, nuk përbën shkak për aprovimin e prapësimin të paraparë me nenin 71 të LPP-së, andaj gjykata pretendimet e tilla nuk mund ti konsideroj të qëndrueshme.

Gjykata i analizoi pretendimet e debitorit, të paraqitura në prapësim, mirëpo këto pretendime nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe, sepse propozimi është bërë duke u bazuar në dokumentin përmbarimor-vendimin e Gjykatës së shkallës së parë i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Mirëpo gjykata vërteton se propozimi për përmbarim është ngritur në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.258/2016 i datës 20.03.2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3469/2018 i datës 21.01.2021, i cili

vendim i është bërë i plotfuqishëm me datë 21.01.2021, dhe i ekzekutueshëm me datë 01.03.2021, andaj vlerëson se janë përmbushur kriteret e përshtatshmërisë së dokumentit përmbartimorë.

Duke marrë për bazë gjendjen faktike gjykata rrjedhimisht konstaton se debitori nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 e deri tek pika 1.12 të LPP-së, andaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit të i'a paguaj edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumën të cilën do ta llogaritë përmbartuesi, konform nenit 13. par.4 të LPP-së.

#### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.38/21 prej dt.13.11.2024

Gjyqtari:  
Burhan Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh ,nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.